KËRKESË
Nr.5843/1, datë 4.12.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rrëshen-Kalimash"(objekte).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Për të gjithë pronarët, për të cilët në kolonën "shënime" në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "I pakonfirmuar", do të kërkohet konfirmim pranë zyrës përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, lidhur me titullin e pronësisë. Pronarët në fjalë do të kompensohen për efekt shpronësimi vetëm pasi të kenë regjistruar pasuritë për të cilat pretendojnë.

Vlera totale e këtij shpronësi është 7 338 382 (shtatë milionë e treqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MPPTT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "RRËSHEN-KALIMASH"
LLOJI I PASURISË: OBJEKTE

	Pronari			**Nr. pas.**	**Objekt, lloji**	**Qyteti/fshati**	**Vlera totale lekë**	**Shënime**
Nr.	**Emri**	**Atësia**	**Mbiemri**					
1	Eridan	Fran	Skana	214/1	Shtëpi banimi	Mashterkor	1052755	I pakonfirmuar
2	Nikoll	Ndue	Biba		Shtëpi banimi	Klos	1395498	I pakonfirmuar
3	Tonin	Mark	Prenga	243	Shtëpi banimi	Thirre	2618565	I pakonfirmuar
4	Nikoll	Gjon	Prenga	244	Shtëpi banimi	Thirre	2271564	I pakonfirmuar
	Totali						7338382	